



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4 dhe neni 29.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 13.09.2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për decertifikimin e kandidatit të Srpska Lista, **Žarko Dejanović**.
- II. Ky kandidat decertifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend Komunal në Komunën e Kllokotit.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj kandidatit **Žarko Dejanović** për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim në përputhje me obligimet që dalin nga neni 29 pika q) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka dërguar emrat e kandidatëve për Zgjedhjet Lokale 2021 për verifikimet e nevojshme. Sipas të dhënave të dërguara nga Këshilli Gjyqësor, kandidati nr. 1 në listën e partisë politike Srpska Lista, **Žarko Dejanović** është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë P. 275/2017 të datës 01.07.2020, që e bën kandidaturën e tij për Zgjedhjet Lokale 2021 në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Sipas nenit 29.4 të nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, kandidati **Žarko Dejanović** ka arritur statusin sipas të cilit ata ka humbur aftësinë për të qenë kandidat. Duke u nisur në çfarë u tha më lartë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur si në dispozitiv.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.